REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1044/23
Datë/Datum. 05.01.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSh. Nr. 1044/23

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Isa Hasani kryetar, Vedat Poterqoi dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik ExFis" Sh.P.K. të datës 22.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjike e Kosovës të datës 11.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me vaj për ngrohje - MAZUT (Fuel Oil 1.0%)" me numër të prokurimit KEK-23-13269-1-1-5, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 05.01.2024 merr këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e operatorit ekonomik "ExFis" Sh.P.K. me nr. 2023/1044 e datës 22.12.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjike e Kosovës të datës 11.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me vaj për ngrohje - MAZUT (Fuel Oil 1.0%)" me numër të prokurimit KEK-23-13269-1-1-5.

II. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjike e Kosovës të datës 11.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

III. **URDHËROHET** konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Korporata Energjike e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 29.11.2023 ka dërguar ftesat për negocim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me vaj për ngrohje - MAZUT (Fuel Oil 1.0%)" me numër të prokurimit KEK-23-13269-1-1-5. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të negocuar me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 695.000.00€.

Me datë 11.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik "Patroni" Sh.P.K.

Me datë 13.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 14.12.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar në tërësi kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 22.12.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/1044.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I)** - "*Pretendimi parë ankimorë sipas ankesës 1044/23 është se OE I rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi i njëjti nuk ka ofruar dëshmi se i plotëson specifikat teknike për mallin e ofruar, pastaj se nuk ka ofruar dëshmi/certifikatë për kualitetin e mallit të ofruar, pastaj se nuk ka ofruar dëshmi document ku ceket prejardhja e mallit të ofruar ose dëshmi nga prodhuesi, pastaj se LOTUS OIL nuk është prodhues por është tregtues i vajrave etj*".
- **Pretendimi i dytë (II)** - "*Pretendimi tjetër ankimorë sipas ankesës 1044/23 është se AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë pasi çmimi i OE të rekomanduar për kontratë i lexuar në hapje, dallon me çmimin e lexuar në raportin e vlerësimit*".

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.12.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 28.12.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Pas analizimit të pretendimeve ankimore, pas analizimit të dosjes së tenderit si dhe ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, fillimisht duhet të sqarojmë se sipas dosjes së te tenderit, asnjë nga këto arsye të cekura nga OE ankues nuk kanë qenë kërkesa të dosjes. Kërkesë e dosjes së tenderit sa i përket kërkesave të përshtatshmërisë profesionale ka qenë vetëm një kërkesë, se OE duhet të jetë i licencuar për importin e vajrave të rënda-mazut. Kërkesa decidive në dosje të tenderit, rubrika 7.1&7.2, pika 4 Kopja e Licencës për import te vajrave te renda për ngrohje - Mazut (Fuel Oil 1.0%). OE i rekomanduar ka ofruar licencë valide për importin e vajrave të rënda. Ndërsa sa i përket çështjeve të ngritura nga OE ankues sa I përket prejardhjes së mallit, prodhuesitetj, këto nuk ka qenë kërkesa të dosjes së tenderit dhe nuk mund të përdoren si arsye për vlerësimapo eliminim të operatorëve ekonomik. Sa i përket çështjes për kualivtetin e mallit, AK në dosje të tenderit në anekësin 1 ka vendosurtabelën/listën me specifika teknike, ku pas tabelës ka vendosur shënimin si në vijim -Tenderuesi duhet të plotësoj dhe nënshkruaj identifikimin që nënkupton se mazuti i liferuar do tejete në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet e shënuara në këtë listë-. OE i rekomanduar ka plotësuar, nënshkruar dhe vulosur identifikimin e tij, me qka faktikisht ka pranuar obligimin se mazuti i liferuar do të jetë në pajtueshmëri me gjitha specifikat e shënuar nëdosje/aneksi 1 specifikat teknike. Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të pabazuara*".

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Pas analziimit të procesverbalit të hapjes, raporteve të vlerësimit, formularit të dorëzimit të tenderit të OE të rekomanduar për kontratë, fillimisht konfirmojmë se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë i lexuar në hapje, çmimi i OE pa TVSH është bartur çmimi njëjtë edhe tek rubrika e çmimit me TVSH. Sido që të jetë në formularin për dorëzim të tenderit OE i rekomanduar ka pas çmimin 700,117.89, çmim ky i cili është lexuar si çmim i hapjes gjatë vlerësimit dhe negociatave. Sipas procesverbalit për negociata, çmimi i ofruar fillimisht 700,117.89 është negociuar në 699,524.89, dhe me këtë çmim të negociuar edhe është rekomanduar për dhënie të kontratës. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore në këtë pikë janë vetëm pjesërisht të bazuara, megjithatë çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar edhe me rastin e ofertimit poredhe me rastin e negocimit ka qenë çmim më i ulët se çmimi i OE ankues*".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Sa i përket pretendimit të parë ankimor, Paneli Shqyrtues nga raporti i ekspertit dhe dosja e tenderit ka gjetur se ky pretendim ankimor nuk i referohet kërkesave të dosjes së tenderit. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar. Duke qenë se edhe eksperti shqyrtues ka arritur deri te përfundimi i njëjtë në këtë rast, Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimin e parë ankimor i ka falur besimin edhe vlerësimeve të ekspertit shqyrtues.

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor, Paneli Shqyrtues nga raporti i ekspertit, dosja e tenderit dhe ofertat me të cilat kanë ofertuar tenderuesit ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim më të ulët sesa operatori ekonomik ankues. Prandaj pretendimi i dytë ankimor është i pabazuar. Paneli Shqyrtues i ka falur besimin edhe pjesës së vlerësimit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë pretendim ku thuhet se "*megjithatë çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar edhe me rastin e ofertimit poredhe me rastin e negocimit ka qenë çmim më i ulët se çmimi i OE ankues*".

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore potencon se në këtë rast kemi të bëjmë me procedurë të negocuar. Në përputhje me LPP dhe RRPP, përgjegjësia për monitorimin e këtyre procedurave të prokurimit i takon Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP).

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Korporata Energjike e Kosovës të datës 11.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me vaj për ngrohje - MAZUT (Fuel Oil 1.0%)" me numër të prokurimit KEK-23-

13269-1-1-5 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Isa Hasani
Kryetar i Panelit Shqyrtues

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.